

 **ARGUMENTUM**
news opinion analysis

80-VJETORI I FITORES MBI NAZIZMIN

Kujtesa që bashkon popujt!



80-VJETORI I FITORES MBI NAZIZMIN/ KUJTESA QË BASHKON POPUJT

Ky edicion special realizohet në nder të 80-vjetorit të Fitores mbi Nazizmin – një moment historik që i dha fund njërës prej periudhave më të errëta të njerëzimit.

9 Maj 1945 shënon një moment të rëndësishëm në historinë e Rusisë dhe të botës: **80 vjetori i Fitores mbi Nazizmin** që solli dhe fundin e Luftës së Dytë Botërore, një ngjarje që nderohet çdo vit me ceremoni madhështore dhe aktivitete të shumta. Ky vit është i veçantë, pasi është një jubile me rëndësi të madhe për popullin rus, i cili kujton sakrificat dhe heroizmin e popullit sovjetik në fitoren kundër një nga regjimeve më të tmerrshme të historisë, atë të **Nazizmit**.

Me këtë botim, synojmë të kujtojmë sakrificat e mëdha, guximin e jashtëzakonshëm dhe bashkimin e popujve përballë një të keqeje globale. Një nga faktorët kyç të kësaj fitoreje ishte roli vendimtar i Bashkimit Sovjetik, i cili mbajti peshën më të rëndë të luftës. Me miliona jetë të humbura dhe një qëndresë heroike, BRSS u bë

një nga shtyllat e fitores së Aleatëve.

Përmes këtij botimi, sjellim në vëmendje jo vetëm rëndësinë e asaj fitoreje, por edhe domosdoshmërinë për të mos harruar kurrë çmimin e lirisë – dhe për të ruajtur paqen si një vlerë universale.

Historia nuk është thjesht një kujtim i largët apo një faqe e mbyllur në libra. Ajo është një pasqyrë e gjallë e asaj që kemi bërë – dhe e asaj që kemi dështuar të bëjmë. Në çdo ngjarje të së shkuarës fshihet një mësim, një paralajmërim, një mundësi për të ndryshuar rrjedhën e së ardhmes.

Ndërsa shënojmë 80-vjetorin e Fitores mbi Nazizmin – një nga luftërat më të përgjakshme dhe më shkatërrimtare që ka njohur ndonjëherë Europa dhe Bota – më shumë se kurrë kuptojmë se **paqja nuk është e dhënë. Ajo është një zgjedhje. Një përpjekje e përditshme.**

Ky përvjetor nuk është vetëm për të kujtuar të kaluarën, por për të ndërgjegjësuar të tashmen.

© 2025 Argumentum

Përmbajtja

SPECIALE

- 80 vjet nga dita e Fitores së Madhe mbi fashizmin: për hir të një të ardhmeje paqësore, është e rëndësishme të mos harrojmë mësimet e së kaluarës.

Nga A.ZAYTSEV,
Ambasadori i Rusisë në Shqipëri

03

SPECIALE

- Reflektime në një 80 vjetor të lavdishëm!

Nga Dr. Jorgji KOTE
Mjeshtër i Madh në Diplomaci

09

SPECIALE

- 80-vjetori i fitores mbi nazifashizmin: rëndësia e saj, roli i BRSS në këtë fitore dhe përpjekjet për rishkrimin e historisë.

Nga Redion LULI
Pedagog/ Ekspert i së Drejtës Ndërkombëtare

14

FOKUS

- Të rrëzojmë muret, të ndërtojmë ura: Historia si udhërrëfyes për të ardhmen.

Nga Marjana Doda, Kryeredaktore-Argumentum.al

19

FOKUS

- Kontributi i Luftës Nacionalçlirimtare Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore: Një betejë e një kombi të vogël kundër një të keqeje globale

22

JO VETEM LAJM

- Ambasada e Rusisë në Tiranë organizon aktivitete me rastin e 80 vjetorit të Fitores së Madhe

24

ARKIVA

- Ngjarjet dhe Zhvillimet kyçe gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Regjimenti i Pavdekshëm

26

ARTIKULL I AMBASADORIT TË RUSISË NË SHQIPËRI, A.ZAYTSEV ME RASTIN E 80-VJETORIT TË FITORES NË LUFTËN E MADHE PATRIOTIKE



A.ZAYTSEV

Ambasadori i Rusisë në Shqipëri

80 vjet nga dita e Fitores së Madhe mbi fashizmin: Për hir të një të ardhmeje paqësore, është e rëndësishme të mos harrojmë mësimet e së kaluarës

Cdo vit, më 9 maj, ne, qytetarët rusë, dhe së bashku me ne qytetarë të shumë shteteve të tjera, festojmë një datë të veçantë në historinë e vendit tonë – Ditën e Fitores së popullit sovjetik në Luftën e Madhe Patriotike 1941-1945. Pikërisht 80 vjet më parë, atmosfera e tragjedisë së rëndë, e vuajtjeve të mëdha njerëzore dhe e luftës së përgjakshme u shpërnda dhe i la vendin ndjenjës së paqes së shumëpritur, lirisë, ngazëllimit dhe shpresës. Në hapësirat e kontinentit evropian mbretëroi më në fund qetësia duke i lejuar njerëzit të krijojnë dhe të ndërtojnë përsëri. Në këtë ditë, njerëzimi mori frymë thellë, u bë dëshmitar i triumfit të drejtësisë, i fitores të

së mirës ndaj të keqes. E keqja absolute – nazizmi dhe fashizmi dhe gjithçka që lidhej me ta: ideologjia njeriurryese, etja për sundim botëror, teoria e epërsisë racore – u shpall e paligjshme nga Tribunali i Nurembergut dhe u refuzua nga e gjithë bota si diçka e pamoralshme dhe e papranueshme. Duke festuar Ditën e Fitores, ne jo vetëm nderojmë heronjtë-fitimtarë, pikëllohem për ata që mbetën përgjithmonë në fushat e betejave, duke sakrifikuar jetën e tyre për të drejtën e brezave të ardhshme për të jetuar, dashuruar dhe rritur fëmijë, por gjithashtu përpiqemi të nxjerrim mësim nga e kaluara historike, t'ua përcjellim ato të rinjve, të cilët nuk i njohën tmerret e luftës dhe

dhimbjen për humbjet e hidhura të atyre, që u vranë nga bombardimet, humbën jetën, duke u tretur në kampet e përqendrim-it, u pushkatuan apo u varën. Nuk duhet të harrojmë se çfarë ishte ajo që solli një kthesë kaq të trishtë të ngjarjeve. Ndërsa “murtaja naziste” po përhapej në gjithë Evropën, kryeqytetet perëndimore, me shpresën për të garantuar sigurinë e tyre në kurriz të të tjerëve, bënë zgjedhjen dritëshkurtër në favor të politikës së pajtimit me regjimin hitlerian, apoteoza e të cilit u bë anshluss-i (aneksimi) i Austrisë në mars 1938 dhe Marrëveshja e Mynihut në shtator 1938. Marrëveshja për ndarjen e Çekosllovakisë, e nënshkruar në Mynih më 30 shtator 1938 nga kryem-

inistrat e Britanisë së Madhe (N.Chamberlain), Francës (E. Daladier), Italisë (B. Mussolini) dhe kancelari i Rajhut gjerman (A. Hitler), shërbeu si një “shakas”, pas të cilit lufta e madhe në Evropë u bë e pashmangshme. Fillimi i saj u parapri nga konfliktet ushtarake në pjesë të ndryshme të botës, të tilla si sulmi i Italisë ndaj Etiopisë (tetor 1935) dhe Shqipërisë (prill 1939), lufta civile në Spanjë (korrik 1936-prill 1939), agresioni i Japonisë kundër Kinës (korrik 1937-shtator 1945). Madje edhe në vitin 1939, kur u bë e qartë se konflikti i armatosur ishte i pashmangshëm, Parisi dhe Londra nuk dëshiruan të pranonin propozimet e përsëritura të BRSS për krijimin e një sistemi të përbashkët të sigurisë kolektive dhe formimin e një koalicioni antihitlerian. Duke besuar në mënyrë naive se nuk do të prekeshin nga lufta, fuqitë perëndimore bënë një lojë të dyfishtë, duke u përkjekur të drejtonin agresionin hitlerian në Lindje, me shpresën se Gjermania dhe Bashkimi Sovjetik do të përplaseshin dhe do të shkatërronin njeri-tjetrin. Si rezultat, më 1 shtator 1939, trupat hitleriane hynë në Poloni, ndërsa në 22 qershor 1941, në agim, Gjermania naziste, pasi shkeli Traktatin e mos-sulmit, të nënshkruar me BRSS në gusht 1939, pa i shpallur luftë, në mënyrë të pabesë, hyri në një front të gjerë në territorin e vendit tonë.

Bashkimi Sovjetik u përball me ushtrinë më të stërvitur, më të mobilizuar dhe më të fuqishme në botë, për të cilën punonte i gjithë potenciali ushtarak, ekonomik dhe industrial i po-

thuajse të gjithë Evropës së asaj kohe. Në këtë pushtim vdekjeprurës mori pjesë jo vetëm Vermahti, por edhe satelitet e Gjermanisë, kontigjentet e shumë shteteve të kontinentit evropian. Kundër makinerisë pushtuese moderne naziste, gjakftohtë dhe të armatosur gjer në dhëmbë u ngrit e gjithë shoqëria sovjetike, e bashkuar me qëllimin për të mbrojtur tokën mëmë, për t'u hakmarrë ndaj armikut që nëpërkëmbi jetën paqësore, planet dhe shpresat për të ardhmen. Për popujt e BRSS lufta zgjati rreth katër vjet. Dëmi, i shkaktuar Bashkimit Sovjetik, ishte kolosal. Dy të tretat e pasurisë kombëtare kishin humbur në territoret e pushtuara. Pushtuesit gjermano-fashistë shkatërruan e dogjën 1710 qytete dhe qyteza, si edhe më shumë se 70 mijë fshatra sovjetikë. U rrënuan më shumë se 6 milionë ndërtesa, rreth 32 mijë ndërmarrje industriale, 84 mijë shkolla dhe

institucione arsimore, 40 mijë spitale dhe poliklinika. 25 milionë njerëz mbetën të pastrehë. E gjithë kjo duhej të restaurohej dhe të ndërtohej nga e para. Që në orët dhe ditët e para të luftës, udhëheqja e lartë politike dhe ushtarake e BRSS kreu një punë shumë të madhe organizative si për të ristrukturuar ekonominë e vendit, duke e fokusuar atë në fushën ushtarake, ashtu edhe për të bashkuar popullsinë civile dhe ushtrinë, me qëllim zmbropsjen e agresorit. Në luftë kundër pushtuesve fashistë u ngrit pothuajse i gjithë populli sovjetik. Në momentin e sulmit të Gjermanisë ndaj BRSS në shërbimin ushtarak ndodheshin afro 5 milionë njerëz. Gjatë viteve të luftës, në ushtri dhe në flotën detare kishte tashmë 34,5 milionë njerëz. Në përbërje të Ushtrisë së Kuqe me armë në duar luftuan përfaqësues të popujve të ndryshëm: rusë, ukrainas, bjellorusë, uzbekë, kazakë, armenë,



Banorët e Moskës gjatë njoftimit të qeverisë në radio për sulmin e pabesë të Gjermanisë naziste ndaj Bashkimit Sovjetik. 22 qershor 1941. Autor: E. Khaldey



Duke besuar në mënyrë naive se nuk do të prekeshin nga lufta, fuqitë perëndimore bënë një lojë të dyfishtë, duke u përkjekur të drejtonin agresionin hitlerian në Lindje. Si rezultat, më 1 shtator 1939, trupat hitleriane hynë në Poloni, ndërsa në 22 qershor 1941, në agim, Gjermania naziste, pasi shkeli Traktatin e mos-sulmit, të nënshkruar me BRSS në gusht 1939, pa i shpallur luftë, në mënyrë të pabesë, hyri në një front të gjerë në territorin e BRSS.



azerbajxhanë, taxhikë, kirgizë, turkmenë, hebrenj, përfaqësues të popujve të vegjël të Veriut dhe Kaukazit shumëkombësh, të cilët u ngritën në mbrojtje të Atdheut të tyre të përbashkët.

Pikërisht Bashkimi Sovjetik dhe Ushtria e Kuqe dhanë një kontribut vendimtar në mposhtjen e nazizmit. Në betejat për çlirimin e territorit të Atdheut të tyre dhe të një sërë vendesh të Evropës humbën jetën 27 milionë qytetarë sovjetikë. Më shumë se 600 mijë ushtarë të Ushtrisë së Kuqe ranë në betejat për çlirimin e Polonisë; rreth 140 mijë për çlirimin e Hungarisë, po kaq për çlirimin e Çekosllovakisë, ku mbrojtja naziste ishte më e fortë. Humbjet e pakthyeshme të Ushtrisë së Kuqe gjatë çlirimit të Gjermanisë arritën në 102 mijë; të Rumanisë – në 69 mijë, të Austrisë – në 26 mijë, të Jugosllavisë – në 8 mijë, të Norvegjisë – në 3,5 mijë, të Bullgarisë – në 1 mijë persona. Është për të ardhur keq që në librat e historisë së shumë vendeve të Evropës së sotme këta të rënë nuk përmenden, herë-herë BRSS madje nuk përfshihet mes vendeve të koalicionit antihitlerian. Sikur e gjithë kjo të mos kishte ndodhur kurrë!

Një rol kyç në çlirimin e territoreve të pushtuara përkohësisht të BRSS luajtën Beteja e Moskës,



Në makineritë e etërve. 1941.
Autor: I.Shagin



Pionierët mbushin thasë me rrëre për të shuar bombat gjermane ndezëse. Korrik 1941. Autor: S.Vasin

e Stalingradit dhe e Kurskut, operacionet sulmuese të Bjellorusisë dhe të Berlinit. Një domethënie të madhe pati fitorja e Ushtrisë së Kuqe në betejën e Stalingradit (korrik 1942-shkurt 1943). Ajo i lejoji Bashkimit Sovjetik të ndryshonte rrjedhën e luftës, të rrëmbente iniciativën strategjike dhe të mos e lëshonte atë deri në fitoren e plotë mbi Gjermaninë fashiste. I rëndësishëm ishte edhe fakti që aleati i Gjermanisë, Japonia, pas rezultateve të kësaj beteje, hoqi dorë përfundimisht nga planet e saj për të hyrë në luftë kundër BRSS. Si rezultat i fitores së Ushtrisë së Kuqe në

betejën e Kurskut në verën e vitit 1943, operacionit të suksesshëm sulmues në Bjellorusi në verën e vitit 1944, u krijua një themel i rëndësishëm për ofensivën e mëvonshme të trupave sovjetike, me qëllim çlirimin e Polonisë dhe përparimin e mëtejshëm të ushtrisë së Kuqe në Gjermani dhe në Ballkan. Operacioni sulmues në Berlin i trupave sovjetike i dha fund Luftës së Madhe Patriotike. Ai është një nga betejat më të mëdha dhe më të përgjakshme të Luftës së Dytë Botërore. Më 20 prill 1945 nisi sulmi ndaj Rajhstagut, dhe për më pak se dy javë armiku u thye

dhe u mposht. Më 8 maj 1945 (9 maj sipas orës së Moskës) në Karlhorst pranë Berlinit u nënshkrua Akti i Kapitullimit të Plotë dhe pa Kushte të Gjermanisë.

Rezistenca heroike e popujve të BRSS kundër ushtrive hitleriane me fuqi superiore frymëzoi miliona qytetarë të vendeve evropiane në luftë kundër fashizmit dhe nazimit. Ushtrisë së Kuqe, partizanët sovjetikë, anëtarët e Lëvizjes së Rezistencës në Itali, Francë, Jugosllavi, Çekosllovakia, Greqi, Belgjikë, Hollandë, Norvegji dhe vende të tjera të Evropës – njerëz të kombësive, pikëpamjeve dhe besimeve të ndryshme, e ndjenë veten si një trup i vetëm kundër forcave të së keqes.

Së bashku me Bashkimin Sovjetik, fitoren ndaj “murtajës naziste” e afroi edhe Shqipëria, e cila ishte pjesë e koalicionit antihitlerian. Që nga viti 1943 në këtë vend nisi një lëvizje masive partizane dhe filloi formimi i Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare. E gjithë kjo solli më 17 nëntor 1944 çlirimin nga pushtuesit gjermanë të kryeqytetit të vendit, Tiranës, dhe më 29 nëntor të po atij viti – të të gjithë



Gratë shoqërojnë ushtarët gjermanë të kapur afër Moskës.

Shqipërisë. Kjo u bë e mundur, në një masë të madhe, falë shpirtit të trupave fashiste në frontin sovjeto-gjerman. Për shembull, në Deklaratën e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, miratuar në Mbledhjen e Dytë në Berat (tetor 1944) thuhej si më poshtë: “Ne e konsiderojmë Ushtrinë e Kuqe si forcën kryesore që mposhti armikun e betuar të njerëzimit. Për ne, ajo është simbol i luftës antifashiste për liri, garancia më e madhe e të drejtave tona. Për këtë, ne i jemi mirënjohës Bashkimit Sovjetik, dhe populli ynë nuk do të harrojë kurrë ndihmën e madhe dhe luftën heroike të Ushtrisë së Kuqe, e cila na shpëtoi nga fatkeqësia”. 28 mijë patriotë trima ranë në

luftë për lirinë e Shqipërisë. Në Rusi kujtojnë dhe nderojnë heroizmin, guximin dhe trimërinë e tyre të pashembullt që ndihmuan në thyerjen e kreshtës së fashistë në Ballkan. Në radhët e Ushtrisë së Kuqe luftuan edhe luftëtarë me rrënjë shqiptare. Midis tyre janë A.D.Spartak (fshati Lekdush), Y.P.Lobaçov (q.Shkodër), E.I.Tanjev (q.Mezhin) etj. Historia e rrugëtimit të tyre ushtarak është përjetësuar në portalin rus “Kujtesa e popullit”, <https://m.pamyat-naroda.ru/>. Çfarë mësimesh kemi nxjerrë nga historia e Luftës së Dytë Botërore? Sigurisht, janë shumë. Megjithatë, mësimi kryesor pas përfundimit të saj ishte ndërgjegjësimi i përgjithshëm se ideologjia e nazizmit është një e keqe absolute dhe se ajo nuk duhet të rilindë më asnjëherë dhe askund. Khatyn-i bjellorus, Buchenwald-i gjerman, Auschwitz-i polak – këta janë emrat e vetëm tre prej dyzetë mijë vendeve, që treguan fytyrën e vërtetë të nazizmit. Është e vështirë të imagjinohet, se sa e përbindshme do të kishte qenë bota nën udhëheqjen e Gjermanisë naziste dhe e aleatëve të saj. BRSS pësoi humbjet më të mëdha në Luftën e Dytë Botërore, duke



Flamuri i fitores mbi Rajhstagun. 2 maj 1945 Autor: E.Khaldey



Fishekszjarrët e Fitores në Moskë.
Pamje e Sheshit të Kuq. 9 maj 1945

paguar një çmim të paimagjinueshëm për Fitoren. Vetëm sipas të dhënave zyrtare, më shumë se 27 milionë qytetarë sovjetikë humbën jetën, nga të cilët të paktën dy të tretat ishin civilë. Por, pas kësaj shifre qëndron tragjedia e përmasave të pazakonta. Miliona të burgosur lufte të torturuar në birucat e kampeve të përqendrimit, të vrarë brutalisht, të vdekur nga uria, të copëtuar dhe të djegur për së gjalli nga forcat ndëshkuese të SS-së dhe mbështetësit e tyre, të vrarë barbarisht nga artileria dhe sulmet ajrore. Miliona fate të thyera. Miliona fëmijë të palindur. Në vendin tonë nuk ka familje që

nuk ka humbur dikë në atë luftë. Viktimat kolosale mes popullsisë sovjetike ishin rezultat i politikës së planifikuar të udhëheqjes hitleriane. Nga materialet e procesit të Nurembergut, bota mësoi për dokumente, të tilla si “Plani i urisë”, i cili parashikonte ndërprerjen e plotë të furnizimit me ushqime të qyteteve sovjetike (i zbatuar pjesërisht gjatë bllokadës së Leningradit), dhe “Dekreti për mosgjykim në Frontin Lindor”, i cili e përjashtonte Vermahtin nga përgjegjësia për krimet e luftës. Në territoret e pushtuara të Rosisë, Bjellorusisë, Ukrainës, Moldavisë dhe vendeve baltike hitlerianët zbatuan politikën e eliminimit të “popullsisë së tepërt”, e cila mbartte të gjitha tiparet e një genocidi. Me fjalë të tjera, rusët dhe popujt e tjerë të Bashkimit Sovjetik zhvilluan një luftë për ekzistencë fizike.

Po çfarë shohim sot? Koha ka kaluar dhe shumë pak dëshmitarë të krimeve të nazizmit kanë mbetur gjallë. Kjo po përdoret nga propagandistët e angazhuar, të cilët nëpërmjet heshtjes, revizionizmit dhe falsifikimit, po

vendosin në një anë të peshores edhe çliruesit, edhe kriminelët nazistë. Në shtetet e Evropës u shfaqën ata, që papritur vendosën të heqin dorë nga e kaluara e tyre heroike dhe të shpallin heronj bashkëpunëtorët dhe kolaboracionistët e Hitlerit dhe të Gëbelsit, dhe të cilësojnë si “të huaj” dhe persona të padëshirueshëm ata, që çliruan nga tmerri nazist Auschwitz-in, Ravensbrück-un, dhe pasardhësit e tyre.

Kështu, në vendet baltike dhe në vende të tjera të Evropës zhvillohen marshime të neonazistëve dhe nacionalistëve që lëvdojnë dhe heroizojnë ata që vranë, varën dhe torturuan mijëra qytetarë të pafajshëm në emër të “Rajhut të Tretë”, të së mirës dhe sundimit të tij botëror. Ne vërejmë prishje masive të monumenteve të heronjve sovjetikë çlirimtarë, përdhosje të varreve, përndjekje të veteranëve, etj. Përpjekjet për të hequr qafe dëshmitë materiale të Luftës së Dytë Botërore është një favorizim i drejtpërdrejt i harresës historike. Nëse ditaret e Ana Frank dhe vajzës leningradase, Tanja Saviçeva janë monumente madhështore në letër, që rrëfejnë për ideologjinë çnjerëzore të nazizmit, atëherë varrezat ushtarake, monumentet e ushtarëve dhe udhëheqësve ushtarakë të rënë janë një monument i gdhendur në gur dhe i shkrirë në metal.

Edhe një shembull tjetër. Pas grushtit të shtetit në 2014, regjimi i Kievit filloi të zbatojë teorinë dhe praktikën e nazizmit në legjislacion dhe në jetën e përditshme; pa hezitim, nisi të organizojë në qendër të Kievit dhe qyteteve të tjera të Ukrainës marshime me pishtarë nën flamujt e divizione-



Banorët e Pragës së çliruar përshëndesin një makinë me ushtarakë sovjetikë. 9 maj 1945. Autor: A.Egorov

ve të SS-së; të praktikojë diskriminim në bazë gjuhësore dhe etnike, viktimë të të cilit, meqë ra fjala, nuk janë vetëm rusët, por edhe komunitetet e tjera kombëtare që jetojnë në Ukrainë. Në mënyrë aktive, u inkurajua në nivel shtetëror glorifikimi i kolaboracionistëve ukrainas që në vitet e luftës bashkëpunuan me pushtuesit nazistë nën maskën e pjesëmarrësve në lëvizjen “nacionalçlirimtare”. Bandera, Shukhevich dhe të tjerë, fajtorë për vrasjet e tmerrshme të hebrenjve, polakëve dhe rusëve, u bënë ikona të Ukrainës moderne. Ndjekësit e tyre aktualë shpallën në vitin 2014 popullsinë e Donbasit “terroriste”, atëherë edhe dogjën për së gjalli 48 persona në Shtëpinë e Sindikatave në Odesa (më 2 maj) dhe ndëshkuan banorët e Mariupolit në Ditën e Fitores (më 9 maj). Duket se Evropa që mbështet me zell politikën e autoriteteve të Kievit, e ka harruar ferrin që i solli gjithë botës ideologjia e fashizmit dhe e nazizmit të shekullit të kaluar. Në arenën ndërkombëtare kanë kumbuar fjalë për epërsinë e një grupi shtetesh ndaj shteteve të tjera, për detyrimin e secilit për të ndjekur një lloj “rendi të bazuar



“Kombat” është një nga fotografitë më të famshme të Luftës së Madhe Patriotike.

Fotoja përshkruan instruktorin politik A.G.Eremenko duke ngritur ushtarët për sulm, disa sekonda para vdekjes së tij. 12 korrik 1942. Autor: M.Alpert

në rregulla”, për ekskluzivitetin dhe të drejtën, që rrjedh a priori prej tij, në të gjitha veprimet dhe hapat. Organizata e Kombeve të Bashkuara, e lindur në zjarrin e Luftës së Dytë Botërore dhe e krijuar për të garantuar paqen e sigurinë, nuk gëzon respektin e merituar. Dispozitat e Kartës së saj respektohen vetëm në mënyrë selektive. Vendimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që janë të detyrueshme për të gjithë, shpesh injorohen, si në rastin e

Marrëveshjeve të Minskut 2015. Tendencat për glorifikimin e nazizmit u ndërthurën me nxitjen e rusofobisë. Përpjekjet për “anulimin” e kulturës, sportit, shkencës ruse, shkelja e të drejtave të qytetarëve rusë për motive politike u bënë tipar tmerrues i epokës. Rusofobia është bërë normë e peizazhit modern politik evropian. Për të parandaluar shfaqjen e një “murtaje naziste” të re, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me iniciativën e Rusisë dhe me mbështetjen e bashkëmbëdhtarëve dhe aleatëve të saj, miraton çdo vit rezolutën për kundërveprimin ndaj glorifikimit të nazizmit. Është e trishtueshme që vendet e Evropës, të udhëhequra nga pikëpamje konjunkturore, gjatë tre viteve të fundit kanë votuar kundër këtij dokumenti të rëndësishëm.

Duam të besojmë që kujtimi për Luftën e Dytë Botërore dhe mësimet e nxjerra prej saj, do të na ndihmojnë të shmangim një katastrofë të re në shkallë të gjerë me viktimë të shumta dhe shkatërime njerëzore edhe më të mëdha. Rusia, ashtu si edhe Shqipëria, e dinë nga përvoja e tyre se çfarë është nazizmi dhe fashizmi. Është në interesat tona që të ndalojmë çdo manifestim modern të epërsisë kombëtare, të mos lejojmë të harrohet bëma e madhe e gjyshërve dhe e stërgjyshërve tanë, falë të cilëve ne jetojmë dhe jemi të lirë, të ndihmojmë në garantimin e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe lulëzimit të shteteve dhe popujve në planet. Pa ekzagjerim, kjo është detyra dhe përgjegjësia jonë e përbashkët para të gjithë botës, para brezave të sotëm dhe atyre të ardhshëm.



Fëmijë të burgosur të kampit të përqendrimit të Auschwitz-it në orët e para pas çlirimit të tij nga Ushtria e Kuqe. Janar 1944. Autor: B.Fishman

Reflektime në NJË 80 VJETOR TË LAVDISHEM!



Takimi i aleatëve - Ushtrisë së Kuqe me trupat e Ushtrisë së Parë të SHBA-së në lumin e Elbës, 25 prill 1945



NGA DR. JORGJI KOTE

MJESHTËR I MADH NË DIPLOMACI

9 MAJI 2025, jubileu i 80-të i fitores historike të koalicionit të madh anti-fashist botëror është ngjarje historike me jehonë plan- etare. Veçanërisht në kushtet e

tanishme ky jubile i ndritur na jep rastin për reflektime në plan- et politike, historike, diplomatike dhe ushtarake, me përfundime të vlefshme për të ardhmen.

Në këtë ditë të shënuar, i thurim homazhe dhe nderime veprës lavdiplote të popujve dhe ud- hëheqësive politike/ushtarake të tre vendeve kryesuese të këtij koalicioni, të cilët dhanë kon- tributin vendimtar në fitoren shpëtimtare të mbarë njerëzimit. Natyrisht mirënjohja më e mad- he shkon për Ushtrinë e Kuqe, Komandantin e saj, Marshallin emblematic Zhukov dhe gjener- alëve të tjerë të shquar që ngritën flamurin e kuq të lirisë në Re- ichstagun famëkeq gjerman; për

popujt sovjetikë, gratë, burrat, të rinjtë dhe të rejat që dhanë dhe jetën e tyre për këtë fitore në beteja madhështore, si në Stal- ingrad, që shënoi “perëndimin” e ushtrisë naziste, në Lenin- grad, Kursk dhe gjetkë. Ushtria e Kuqe asgjësoi rreth 4 milionë nga 5,5 milionë ushtarë nazistë që mbetën të vrarë; po ashtu, ish Bashkimi Sovjetik pagoi çmim- in më të shtrenjtë të asaj lufte, me mbi 16 milion civilë dhe 8 milion ushtarë të vrarë në luftime heroi- ke; veç miliona të plagosurve dhe dëmeve të pallogaritshme mate- riale dhe financiare.

Homazhe dhe nderime të mëdha shkojnë për popujt amerikanë dhe britanikë, liderët e tyre his-

torikë, Roosevelt dhe Çurçill, komandantët e shquar të ushtrive të tyre, Gjeneralit Eisenhower më vonë President i SHBA-ve, Feld Marshallit britanik B.L. Montgomery dhe për qindra mijra ushtarë dhe oficerë që u erdhën në ndihmë aleatëve të tyre evropianë bashkë me trupat franceze dhe kanadeze, ku shkëlqyen sidomos në betejën e famshme të Normandisë, ky “Stalingrad” në brigjet franceze.

Nderim dhe respekt për popujt dhe ushtritë e 57 vendeve të tjera pjesëmarrëse në aleancën e madhe anti-fashiste botërore, të cilët përfaqësonin 80 për qind të popullsisë së botës; aty bën pjesë dhe Shqipëria me Ushtrinë e saj Nacional – Çlirimtare dhe forca të tjera atdhetare që luftuan kundër nazi-fashizmit. Vepra, sakrificat, gjaku dhe mundimet e tyre janë të pavdekshme në panteonin e madh të lirisë. Heroizmi i treguar në atë luftë të përgjakshme është skalitur në mijra poezi, këngë, filma, libra, shfaqje teatrale, muzeume, skulptura, etj.

Në këtë jubile të madh, krahas homazheve, historianët, politikanët, analistët, ekspertët e luftës dhe sigurisë kanë mundësinë dhe detyrimin të reflektojnë më shumë mbi shkaqet që çuan në Luftën e II Botërore, pasojat dhe mësimet prej saj.

Si bir i një familje partizani, si diplomat dhe në Berlin, kam patur rastin të marr pjesë aktive në diskutime dhe veprimtari të ndryshme përkujtimore, ku jam takuar dhe me familjarë luftëtarësh dhe heronjsh të shquar. Në librin “Berlini pa mure” kam analizuar, ndër të tjera, “pse-të” dhe pasojat e asaj lufte e sidomos të disfatës na-



Fshatarët jugosllavë përshëndesin pilotin sovjetik që zbarkoi në territorin jugosllav. 1944. (Autori: E.Khaldey)

ziste, të cilat po i parashtroj të përditësuara shkurt më poshtë. Së pari, le ta theksojmë se ajo çka ndodhi në botë mbas vitit 1945 nuk i shton asnjë lloj faji e përgjegjësie dhe as i cënon fare meritat dhe heroizmin e rrallë të Ushtrisë së Kuqe, gjeneralëve dhe ushtarëve të saj të pamposhtur. Vepra, gjaku, heroizmi i tyre nuk mund të zvenitet e ca më pak të shuhet, pavarësisht nga zhvillimet e mëvonshme në botë, në Rusi, SHBA, në Gjermani e gjetkë. Populli, ushtarët, dhe komandantët sovjetikë dhanë gjithçka, jetën dhe rininë e tyre për të shpëtuar vendin dhe botën nga hordhitë e tërbuara naziste. E njëjta gjë mund të thuhet për heronjtë dhe dëshmorët tanë të Luftës Nacional – Çlirimtare, të cilët nuk ka përse të gjykojnë dhe viktimizohen pa të drejtë për pjesëmarrjen dhe heroizmin e tyre në luftë për shkak të asaj çka ndodhi më vonë në vendin tonë. Thjesht sepse ata luftonin, jepnin dhe jetën për idealin e shpëtimit kombëtar nga pushtuesit, pa e ditur se çfarë gatuhej prapa shpinës së tyre në kuzhinat politike të asaj kohe.

Më tej, në këtë jubile të madh del

më qartë në dritë roli regresiv i bashkëputorëve të nazifashizmit, të cilët nuk munguan, as në Ballkan dhe në vendin tonë. Këtu nuk qëndrojnë teorizimet dhe justifikimet me rrezikun e komunizmit, si shkaqe dhe motive që i shtynë jo pak njerëz të bëheshin bashkëpunëtorë të nazizmit. Pavarësisht synimeve, objektivave dhe akteve politike të forcave komuniste mbas lufte dhe sistemit politik të krijuar, një ngjarje historike gjykohet drejt duke marrë në shqyrtim kohën dhe rrethanat konkrete, domosdoshmërinë që buronte nga imperativat e asaj



Bashkimi Sovjetik pagoi çmimin më të shtrenjtë të asaj lufte, me mbi 16 milion civilë dhe 8 milion ushtarë të vrrarë në lufte heroike; veç miliona të plagosurve dhe dëmeve të pallogaritshme materiale dhe financiare.





Shatërvani "Vallja e fëmijëve" në sheshin e stacionit të Stalingradit pas një sulmi ajror nazist. 23 gusht 1942. (Autor: E.Evzerikhin)

kohe dhe kontributi i tyre në fitoren mbi nazi-fashizmin; për të tjerat kishte kohë për t'u gjykuar më vonë, siç dhe vazhdon të bëhet kudo.

Aspekti tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me ndarjen e meritave të fitores historike dhe pa konsiderata ideologjike; në fakt, është konfirmuar me kohë dhe nga vetë protagonistët kryesorë të asaj lufte dhe drejtuesit më të lartë të shteteve të koalicionit anti-fashist. Në Konferencën e Teheranit në dhjetor 1943, Stalini kishte pranuar se "pa SHBA-të dhe mbështetjen e saj nuk do të ishte fituar ajo luftë". Po ashtu, në takimin jubilar me rastin e 60 vjetorit të fitores mbi fashizmin më 9 Maj 2005, Presidenti Putin e tha shprehimisht se "Ne nuk e kemi ndare fitoren si tonën apo si të atyre. Ne do të kujtojmë me nderim SHBA-të, Britaninë e Madhe dhe Francën për kontributin e tyre në këtë fitore".

Madje këtu do shënuar dhe deklarata e bujshme e ish Presidentit të ndjerë gjerman Richard von Kurt Weizsäcker 40 vite më

parë se "8 Maji 1945 ishte dhe dita e çlirimit të vetë Gjermanisë".

Moment tjetër delikat është legjitimiteti dhe justifikimi i gabuar i agresionit hitlerian më 22 Qershor 1941 me frikën nga ekspansioni komunist sovjetik në Gjermani, siç shprehet në disa studime dhe analiza të huaja.

Pa e injoruar ndikimin në Gjermani të Revolucionit të Madh të Tetorit 1917, një mori faktesh, të dhënash dhe studimesh autoritare vërtetojnë se kjo tezë është e pasaktë dhe e shtrembëruar, madje qëllimisht.

Pikë së pari, në Gjermani lëvizja komuniste ka qenë e pranishme dhe përpara vitit 1917; kemi parasysh ideologun e tij, Karl Marks bashkë me figura të tjera të njohura si Karl Liebknecht dhe Roza Luksemburg, të cilët u ekzekutuan më 1919.

Ndërkohë, lind me të drejtë pyetja se mirë me Bashkimin Sovjetik, po me Poloninë, Britaninë e Madhe dhe me Francën, ç'pati Hitleri? Pastaj, përse amerikanët dhe britanikët nuk bënë koali-

cion me Hitlerin kundër ish BS-së?; kur ata ishin jo vetëm anti-komunistë por dhe demokratë "24 karat". Aq sa dhe Çurçilli, ky anti-komunist dhe demokrat liberal proverbial, deklaronte se jo me Stalinin, por dhe me djallin do të bënte pakt për ta shporur Hitlerin dhe nazizmin, si rreziku më i madh për botën!

Në fakt, shkaku i parë themelor i lindjes, rritjes dhe agresionit nazist lidhet me gjendjen social - ekonomike gjermane. Kështu, brenda 5 viteve papunësia atje u trefishua! Duke shënuar kulmin gjatë periudhës 1929 - 1933 kur Depresioni i Madh Ekonomik pllakosi dhe Gjermaninë.

Në këtë situatë kaotike, më 9 Nëntor 1918, Karl Liebknecht shpalli Gjermaninë "Republikë Socialiste". Në një kundëreagim publik, po atë ditë, personaliteti tjetër i madh social - demokrat Philipp Scheidemann e shpalli Gjermaninë nga dritaret e Reichstagut "Republikë Demokratike Parlamentare". Në këto situata të tensionuara, me përplasje dhe ballafaqime të shumta ush-



Bullgaria ngazëlllyese. Koça Karadzhev, komandanti i partizanëve. Shtator 1944. (Autor: E.Khaldey)

tarake në Berlin u vu në krye të lëvizjes progresive dhe shpëtimtare për kombin gjerman, social-demokrati i famshëm i Friedrich Ebert, i cili u zgjodh presidenti i parë gjerman, por ai vdiq shumë parakohe, duke e futur sërish vendin në udhëkryq. Pikërisht në këtë situatë kishin filluar të dilnin në skenë nacional – socialistët me Adolf Hitlerin në krye, të mbështetur nga “freicorpet” ose trupat besnikë të Mbretit që ishin përhapur tmerr dhe terror në gjithë Gjermaninë. Shkaku i dytë madhor i jashtëm por me ndikime përcaktuese dhe brenda vendit ishte Traktati i Paqes i Versajës i vitit 1920 i cili, siç dihet, imponoi sanksione tejet të ashpra ekonomike dhe ushtarake, të pamundura për t’u zbatuar nga Gjermania demokratike, mbasi ato çonin në rrënimin e saj të plotë. Këto sanksione dhe reparacionet e luftës së I-rë shërbyen si “lëndë e parë lufte për rritjen e pandalshme të nazizmit, i cili u shfaq përpara publikut të pashpresë me premtimin e bujshëm

për ta bërë prapë Gjermaninë të madhe dhe mbi të gjithë”.

Natyrisht këtu atë e ndihmoi dhe indiferenca e SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe Francës, të cilat i “mbajtën iso” pse të mos e themi kështu; maje, me shumë naivitete nuk i bojkotuan, por muarën pjesë në Lojrat Olimpike 1936 në Berlin, të cilat rezultuan një pasqyrë dhe vitrinë kozmetike dhe sportive e nazizmit gjerman që mezi po priste të shfaqej me brutalitetin e tij.

Shkaku i tretë themelor kishte të bënte me miratimin e Kushtetutës demokratike gjermane me 11 Gusht 1919 e cila u bë baza e Republikës së Weimarit (1919 – 1933). Mirëpo, ajo pati disa difekte dhe paqartësi serioze, të cilat ndikuan në dështimin e Weimarit dhe në ngjitjen e Hitlerit.

Kështu, Kushtetuta e kthente vendin në një Republikë gjysëm Presidenciale, ku Presidentit i jepeshin pothuajse të gjitha atributet e Monarkut; kjo u shfrytëzua nga Hitleri për të ka-

pur kompetencat presidenciale mbas vdekjes së Hindenburgut. Difekt edhe më i madh ishte një ligj i cili mund t’i kundërvihet Kushtetutës, kur të kalonte me 2/3 e votave në Parlament! Edhe kjo klauzole u përdor mjaft nga regjimi hitlerian për ta “zhveshur Republikën” nga çdo element demokratik.

Ndërkohë, falë “Mosbesimit”, Kushtetuta specifikonte se Kancelari Federal mund të hiqej me shumicë të thjeshtë votash nga Parlamenti. Por, kjo e nxiti Hitlerin që të provokonte zgjedhje të parakohshme duke shfrytëzuar kompetencat e deleguara presidenciale, të shoqëruara me tubime hysterike, me presione radikale e ekstremiste që të ngjitej në pushtet duke siguruar shumicën parlamentare.

Faktori i katërt me ndikimin e vet të madh në “shkeljen me të dy këmbët” të Kushtetutës ishte mungesa e traditës dhe dëshirës për demokraci në Gjermani. Sipas shumë analistëve dhe historianëve, gjermanët vlerësonin

më tepër bindjen e verbër, pasivitetin, prepotencën, arrogancën dhe “Deutsch Kulturën”. Siç pohon Erich Fromm, “shumica e gjermanëve kishin ndërtuar një terren të tillë, ku fara e hedhur nga Hitleri mundi pa vështirësi të mbillej dhe lulëzonte” Ndaj Republika e vajmarit konsiderohet si “demokraci pa demokratë”. Në këto kushte, Hitleri dhe pasuesit e tij vepruan më me lehtësi, duke përhapur idenë se qytetaria, kultura, e sidomos demokracia liberale nuk ishin vlera të qenësishme për Gjermaninë.

Për këto arsye, përvoja e hidhur e dështimit të Weimarit dhe instalimi i nazizmit në pushtet u mbajtën parasysh në hartimin e Ligjit Bazë Kushtetues gjerman në vitin 1949 dhe më tej. Në 146 nenet e tij përfshihen 19 të drejta dhe liri themelore të cilat janë të paprekshme dhe të pacënueshme në çdo rrethanë dhe situatë!

Shkaku i fundit por jo më pak i rëndësishëm madhor i përshkallëzimit agresiv të nazizmit ishte politika dhe diplomacia e gabuar “qetësuese ose zbutëse” që ndoqën britanikët dhe francezët



Shkaku i përshkallëzimit agresiv të nazizmit ishte politika dhe diplomacia e gabuar “qetësuese ose zbutëse” që ndoqën britanikët dhe francezët ndaj Gjermanisë naziste në fund viteve 30. Kjo arriti kulmin me Paktin e Munihut në shtator 1938.



ndaj Gjermanisë naziste në fund viteve 30. Kjo arriti kulmin me Paktin e Munihut në shtator 1938, kur në vend “t’i vinin kufirin te thana” Hitlerit, Kryeministri britanik Chamberlen dhe ai francez, Daladier menduan me naivitet se duke i falur Hitlerit sudetet çeke, atij do t’i shuhej etja aneksioniste. Kjo rezultoi bllof, sepse atij iu shtua dhe më shumë ai oreks; Hitleri vijoi me pushtimin e Polonisë, Çekisë, bombardimet ndaj Londrës dhe sulmin ndaj BS më 22 Qershor 1941.

Me këtë rast, ka shumë rëndësi të bëhet dallimi i qartë midis gjermanëve dhe nazistëve, sepse një numër i madh gjermanësh, qoftë dhe në heshtje në kushtet eurvejimit dhe persekutimit nga SS dhe Gestapo ishin kundër nazizmit, edhe pse anti-komunistë. Shembulli më i ndritur i rezistencës anti-hitleriane ishte atentati i dështuar i Kolonel Claus von Stauffenberg më 20 Korrik 1944 në shtabin e Hitlerit, i 13-ti atentat ndaj tij. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për atentat nga një ushtarak i lartë i vetëm, sepse me të ishin mbi 5000 bashkëpunorë, oficerë të lartë, 22 gjeneralë dhe feldmarshallë. Fillimisht simpatizant i Hitlerit, duke ngjitur shkallët e hierarkisë ushtarake, 37 vjeçari Stauffenberg vinte nga familje kontësh katolikë besnikë dhe anti-komunistë të vendosur. Mirëpo shpejt ai u indinjua me shumë akte dhe veprime të Hitlerit, sidomos prishja e Paktit me Kishën katolike, planet për shfarosjen e hebrenjve, duke arritur kulmin kur ai nuk lejoi tërheqjen e trupave nga Stalingradi. Ai kishte deklaruar se “e analizova veten para Zotit dhe ndërgjegjes dhe vendosa

ta bëja atentatin, se Hitleri përfaqëson djallin vetë. E di se po ta kryej këtë atentat do më quajnë tradhëtar të Atdheut, por, po nuk e bëra do jem tradhtar i ndërgjegjes sime”.

Me dy gishtërinj të prerë në dorën e djathtë dhe një sy të humbur në një betejë në Prill 1944 Stauffenberg qëllloi i pafat për shkak të disa ndryshimeve në orar, në vendin ku vendosi bombën dhe lëvizjeve të Hitlerit, i cili u plagos pa rrezik për jetën. Kujtimi dhe vepra e Stauffenberg dhe shokëve nderohet me ceremoni solemne çdo vit, aty në “Bendler Platz” ku u ekzekutua natën e 20 korrikut 1944 dhe kudo në Gjermani; emrin e tij dhe të shokëve e mbajnë rrugë, shkolla, etj.

Së fundi, bashkëpunimi i Stalin-it, Çurçillit dhe Rooseveltit/Trumanit gjatë dhe pas Luftës së II Botërore, pavarësisht nga dallimet e papajtueshme ideologjike, mbeten shembull referues që tregojnë se si dhe problemet më shqetësuese mund të trajtohen dhe zgjidhen mes krerëve të superfuqive me bisedime, konsultime, ama me lëshime dhe kompromiset e rastit, ku të gjithë të jenë ose të paktën të mendojnë se janë fitues (win – win). Kjo tingëllon dhe më shumë aktuale sot, kur bota po kalon aq shumë kriza dhe konflikte të dhunshme, të cilat mund të shmangen në mënyrë paqësore, me bisedime e jo ultimatumet “merre ose lere” dhe duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare, institucioneve të ngritura mbas lufte dhe jo jashtë tyre.

Ja pse, më 9 Maj, në jubileun e madh të lirisë, kumbon fort mirënjohja e pafund dhe brohoritjet planetare: “Lavdi 80 Vjetorit të fitores mbi nazi-fashizmin!

80-VJETORI I FITORES MBI NAZIFASHIZMIN:

Rëndësia e saj, roli i BRSS në këtë fitore dhe përpjekjet për rishkrimin e historisë



Nga REDION LULI

PEDAGOG/ EKSPERT I SË
DREJTËS NDËRKOMBËTARE,
UNIVERSITETI MESDHEJAR I SHQIPËRISË

Për përcaktimin e kuptimit të fitores në Luftën e Dytë Botërore dhe përmbledhjen e rezultateve të saj, para së gjithash, është e nevojshme të marrim si pikënisje arritjen e qëllimeve të vendosura në të nga palët ndërluftuese. Qëllimet e Rajhut të Tretë ishin skllavërimi dhe shfarosja e popujve europianë, si dhe pushtimi dhe eliminimi i BRSS si shtet. BRSS dhe aleatët e tij në koalicionin antihitlerian vendosën si qëllimin më të rëndësishëm mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së popujve të tyre dhe të popujve të tjerë, mposhtjen dhe çrrënjosjen e fashizmit gjerman dhe militarizmit japonez. Gjermania, Italia, Japonia dhe aleatët e tyre u mposhtën; u eliminua regjimi racist që ata u imponuan popujve të shumë vendeve. BRSS dhe shtetet e tjera të koalicionit antihitlerian, pasi shtypën



Maria Shalneva, një tetare e batalionit të veçantë të 87-të të mirëmbajtjes së rrugëve, rregullon lëvizjen e makinave ushtarake pranë Reichstag-ut në Berlin, maj 1945. Autor: E.Khaldey

agresorët, çliruan territoret e pushtuara, dëshmuar inkonsistencën dhe rrezikun e madh që përfaqësonte për të ardhmen e njerëzimit ideologjia naziste, e cila shërbeu si bazë për përgatitjen dhe zhvillimin e luftërave pushtuese në vitet 1930-1940. Rezultati kryesor i Luftës së Dytë Botërore duhet konsideruar, para së gjithash, fitorja mbi fashizmin. U zhduk kërcënimi i skllavërimit dhe shkatërrimit të pjesshëm të

njerëzimit.

Humbjet më të mëdha i pësoi Bashkimi Sovjetik, i cili mbajti dhe peshën më të rëndë në këtë luftë tragjike; nazistët dërguan dy të tretat e trupave të tyre në Frontin Lindor. Më shumë se 28 milionë sovjetikë u vranë. Pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre dogjën dhe shkatërruan 1.710 qytete dhe qyteza, më shumë se 70.000 fshatra, shkatërruan plotësisht ose pjesërisht

Humbjet më të mëdha i pësoi Bashkimi Sovjetik, i cili mbajti dhe peshën më të rëndë në këtë luftë tragjike; nazistët dërguan dy të tretat e trupave të tyre në Frontin Lindor. Më shumë se 28 milionë sovjetikë u vranë.

1.5 milion ndërtesa dhe 31.850 ndërmarrje industriale. Në BRSS rreth 25 milionë njerëz humbën shtëpitë e tyre. Asnjë komb nuk u kursye nga humbjet njerëzore dhe shkatërrimet. Më shumë se 6 milionë njerëz vdiqën në Poloni, 5.5 milionë në Gjermani. Britania humbi 4 milionë e 190 mijë njerëz, India - më shumë se 3 milionë njerëz, Franca - 2 milionë e 685 mijë njerëz. Më shumë se 5.5 milionë e popullsisë hebreje të Europës u përndoq dhe u asgjësua mizorisht në kampet e përqëndrimit nga nazistët. Miliona njerëz humbën jetën në Kinë, Indonezi dhe Indokinë. Japonia humbi 2.5 milionë njerëz. Kjo listë e trishtë mund të vijohet më tej. Lufta e Dytë Botërore mund të çonte në kolapsin e qytetërimit. Popujt e botës në gjyqin e Nurembergut dënuan kriminelët e luftës dhe ideologjinë fashiste.

Ndikimi i rezultateve të Luftës së Dytë Botërore në rrjedhën e mëtejshme të historisë botërore mund të përmbledhet në tezat e mëposhtme:

- Shumë popuj të botës u shpëtuan nga shkatërrimi, siç dëshmohet nga përjetësimi i ushtarit-çlirimtar sovjetik në monumente dhe memorialë të ngritur në shumë qytete europiane. Askund dhe kurrë në botë nuk janë ngritur kaq shumë monumente për ushtritë e huaja që çliruan shtetet nga pushtuesit në një luftë.

Çlirimi i popujve të robëruar nga fashizmi, kthimi i sovranitetit të tyre kombëtar dhe shtetëror përbën një ngjarje me rëndësi botërore. Nën thembërin e agresorëve fashistë gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin Austria, Shqipëria, Belgjika, Greqia, Danimarka, Luksemburgu,



Beteja e Stalingradit, oficerët e Ushtrisë së Kuqe

Holanda, Norvegjia, Polonia, Franca, Çekoslovakia, Jugosllavia.

Më 7 nëntor 1941 I.V. Stalin, në një fjalim drejtuar ushtarëve sovjetikë gjatë paradës ushtarake në Sheshin e Kuq, theksoi: "Popujt e robëruar të Europës, të cilët ranë nën zgjedhën e pushtuesve gjermanë, ju shikojnë si çlirimtarët e tyre. Misioni i madh çlirimtar ka rënë mbi ju". Si rezultat i operacioneve luftarave të Ushtrisë së Kuqe në gusht 1944, në Rumani ra regjimi fashist. Më pas, trupat sovjetike çliruan Beogradin dhe Budapestin, Varshavën dhe Bratislavën, Pragën dhe Vjenën. Në total, në të gjithë Europën ka katër mijë monumente dhe memoriale ushtarake për ushtarët dhe oficerët e Forcave të Armatosura Sovjetike që çliruan popujt europianë dhe dhanë jetën në rrugën drejt fitores mbi fashizmin.

Siç thoshte Ernest Heminguej: "Kushdo që e don lirinë, i ka Ushtrisë së Kuqe një borxh që nuk do të mund të shlyhet dot kurrë".

- **Regjimi racist u likuidua, qytetërimi u shpëtua nga**

fashizmi, duke ruajtur kështu vektorin progresiv të zhvillimit të historisë botërore.

Si rezultat i fitores së BRSS, u mposhtën jo vetëm forcat e armatosura të Gjermanisë dhe satelitët e saj, por edhe forcat militariste dhe burimet e luftërave të reja. Bashkë me ta u likuiduan regjimet politike më çnjerëzore, më reaksionare në këto vende. Fitorja forcoi dhe intensifikoi dëshirën e popujve për një rend të ri shoqëror të bazuar në parimet demokratike dhe krijoi mundësinë për të formuar një botë të bazuar në parimet e arsyes dhe bon sensit.

- **Përvoja e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet shteteve u pasurua me metoda dhe forma të reja.**

Lufta e pasuroi historinë me përvojën e bashkëpunimit ndërkombëtar midis shteteve që ishin pjesë e koalicionit antihitlerian. Megjithatë kjo përvojë u ndërlikua nga dallimet e thella në strukturën e brendshme politike dhe drejtimin e interesave gjeopolitike të aleatëve, pati shumë aspekte pozitive në përvojën e ndërveprimit të tyre në fund të

Luftës së Dytë Botërore, gjë që krijoi bazën për një fazë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Fitorja u arrit me përpjekjet e përbashkëta të vendeve pjesëmarrëse në koalicionin antihitlerian, por barrën kryesore të luftës e mbajti populli sovjetik. Për gati katër vjet, fronti sovjetiko-gjerman tërhoqi pjesën më të madhe të forcave dhe burimeve të Gjermanisë - 72% të numrit të përgjithshëm të njësive gjermane që ishin pjesë e Forcave të Armatosura. Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe i dhanë Bashkimit Sovjetik ndihmë të konsiderueshme financiare. Filimisht, ndihma për BRSS u dha në sasi relativisht të vogla në krahasim me dërgesat e planifikuara. Në të njëjtën kohë, ajo kompensoi pjesërisht rënien e ndjeshme të prodhimit ushtarak sovjetik për shkak të pushtimit të një pjese të konsiderueshme të territorit të BRSS nga nazistët. Pas kapitullimit të Gjermanisë, Shtetet e Bashkuara ndërprejnë dërgesat në kuadër të Lend-Lease në pjesën europiane të BRSS, por i vazhduan ato për ca kohë në Lindjen e Largët Sovjetike për shkak të luftës kundër Japonisë.

Duke pranuar kontributin e SHBA-ve, në 1945, Stalini shprehu qëndrimin se marrëveshja sovjetiko-amerikane e Lend-Lease-it luajti një rol të rëndësishëm dhe kontribuoi ndjeshëm në përfundimin me sukses të luftës kundër armikut të përbashkët. “Ne kurrë nuk e kemi konsideruar ndihmën tonë në kuadër të Lend-Lease si faktorin kryesor të fitores sovjetike ndaj Hitlerit në Frontin Lindor”, - theksonte G. Hopkins, përfaqësues personal i presidentit amerikan F. Roosevelt. “Ajo u arrit me heroizmin dhe gjakun e ushtrisë ruse”.

- E Drejta Ndërkombëtare u plotësua me përmbajtje të re për zgjidhjen e problemeve të luftës dhe paqes, komuniteti ndërkombëtar dënoi teorinë dhe praktikën e nazizmit dhe u krijuan Kombet e Bashkuara (OKB).


Akti më i rëndësishëm që përcaktoi *de jure* rezultatet socio-politike të luftës ishte vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake për gjykimin e kriminelëve të luftës, i cili dënoi teorinë, praktikën dhe institucionet e vendeve agresore, si dhe ata që ishin drejtpërdrejt përgjegjës për inicimin e luftës dhe metodat barbare të saj. Më 20 nëntor 1945, në orën 10:00, në qytetin gjerman të Nurembergut u hap procesi gjyqësor ndërkombëtar i kriminelëve kryesorë nazistë të luftës të vendeve europiane të boshtit “Romë-Berlin-Tokio”. Vendimi për mbajtjen e gjyqit u mor në Konferencën e Krimesë (Jaltë) të liderëve të koalicionit antihitlerian (4-11 shkurt 1945).

“ Një nga instrumentet efektive për ruajtjen e paqes pas luftës u bë verimtaria e OKB-së. Ajo ishte dhe mbetet një ndër arritjet më kryesore të shteteve të koalicionit antihitlerian. ”

Një nga instrumentet efektive për ruajtjen e paqes pas luftës u bë veprimtaria e OKB-së. Emërtimi “Kombet e Bashkuara”, i propozuar nga presidenti amerikan Franklin D. Roosevelt, u përdor për herë të parë më 1 janar 1942, në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, kur përfaqësuesit e 26 shteteve u zotuan në emër të qeverive e tyre, për të vazhduar luftën e përbashkët kundër fuqive të Boshtit. OKB-ja ekziston zyrtarisht nga 24 tetori 1945. Deri në këtë ditë, Karta e OKB ishte ratifikuar nga shtetet që mundën fashizmin: Britania e Madhe, Kina, Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca dhe shumica e shteteve të tjera nënshkruese. Edhe pse për hir të së vërtetës në ditët e sotme aktiviteti i kësaj organizate përballet me kritika të qëndrueshme në lidhje me rolin e saj të zbehtë në zgjidhjen e konflikteve aktuale që minojnë sigurinë ndërkombëtare, OKB-ja ishte dhe mbetet një ndër arritjet më kryesore të shteteve të koalicionit antihitlerian.

- Botës iu dha një mësim serioz: vendi agresor humbi shtetshmërinë dhe integritetin e tij territorial, ndërsa dhuna e ushtruar në shkallë globale u kthye në një tragjedi për popullin e tij.

Rezultatet e luftës për Gjermaninë ishin të paprecedentë: humbjet e pariparueshme arritën nga 8 deri në 13 milionë njerëz, 12 milionë gjermanë u zunë robër dhe 12 milionë të tjerë u kthyen në refugjatë; qytetet dhe infrastruktura e vendit u shkatërruan; prodhimi industrial ra me më shumë se 40%, dhe një krizë akute përfshiu bujqësinë dhe transportin; Gjermania pagoi reparacionet e luftës; vendi humbi shtetshmërinë dhe



Parada e Fitores. Moskë. Sheshi i Kuq, 9 Maj

integritetin e tij territorial për shumë vite; disa pjesë të territorit iu dhanë Polonisë, BRSS dhe Francës.

- U krijuan kushtet për shembjen e sistemit kolonial; shumë popuj të Azisë, Afrikës dhe Amerikës fituan për herë të parë pavarësinë kombëtare.

Maji i vitit 1945 i dha hov qasjeve të reja globale. Për shumë vende të Azisë, Afrikës dhe Amerikës nisi procesi i çlirimit nga varësia koloniale. Nëse në fillim të Luftës së Dytë Botërore rreth 70% e popullsisë dhe 77% e territorit të globit ishin pjesë e sistemit kolonial, nga mesi i viteve 1970 këto shifra ishin më pak se 1%. Më shumë se 100 shtete sovraane u formuan në vendet e ish-kolonive të Britanisë së Madhe, Francës, Italisë, Turqisë dhe Holandës. Vendet e pushtuara nga Japonia fituan pavarësinë. U shfaqën qendra të

reja ndikimi dhe bota u bë gjithnjë e më bipolare. Në balancën e fuqisë midis Perëndimit dhe Lindjes, roli kryesor tani i përkiste Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u rrit polarizimi politik dhe social në botë, siç u intensifikua edhe përballja midis modeleve liberale dhe socialiste, e cila zakonisht njihet me emërtimin “Lufta e ftohtë”. Kjo ishte një luftë shumëplanëshe për interesat gjeopolitike që ish-aleatët filluan të zhvillojnë kundër njëri-tjetrit pothuajse menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Sot, edhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik, kjo luftë po intensifikohet. Bota është dëshmitare e përpjekjeve për të falsifikuar historinë e Luftës së Dytë Botërore. Objekti kryesor i “rishikimit” janë aspektet më të rëndësishme të luftës - historia e periudhës së paraluftës, opera-

cionet ushtarake të komandës së Ushtrisë së Kuqe, roli dhe rëndësia e fronteve të ndryshme, humbjet sovjetike në luftë, çmimi i fitores, etj.

Disa politikanë europianë përpiqen të fshijnë me zell nga kujtesa e europianëve rolin e Ushtrisë së Kuqe në çlirimin e vendeve të tyre dhe të pjesës tjetër të Europës nga nazizmi. Në disa shtete europiane nuk kanë më siklet t’i quajnë ushtarët e Ushtrisë së Kuqe jo “çlirimtarë”, por “pushtues”. Vlen të theksohet se falsifikimi i rezultateve të kësaj lufte filloi në vitin 1945, menjëherë pas fitores. Fillimisht, ajo mori formën e një lufte dezinformimi, duke u bërë gradualisht një pjesë integrale e Luftës së Ftohtë dhe duke mbetur e tillë, në fakt, edhe sot e kësaj dite.

Për disa shtete të Europës përshatja e fakteve të luftës me drejtimin që u intereson atyre

nënkupton një mundësi për të “zbardhur”, rehabilituar qëndrimet e tyre, për të justifikuar pasivitetin e tyre gjatë viteve të luftës kundër fashizmit. Rishkrimi i historisë së luftës është në dobi edhe të vetë Gjermanisë. Duke i mëshuar tezës se gjoja “Rajhu i Tretë dhe BRSS mbajnë përgjegjësi të barabartë për fillimin e luftës”, faji historik i gjermanëve nuk do dukej më aq absolut sa ç’është në realitet. Falsifikimi i historisë së Luftës së Dytë Botërore është në interesin e aleatëve të Gjermanisë naziste: në këtë rast, do të rezultonte se ata nuk luftuan në anën e së keqes absolute, por ishin thjesht pjesë e një prej blloqeve gjeopolitike. Shtrembërimi i historisë së Luftës së Dytë Botërore është në dobi të kolaboracionistëve që bashkëpunuan me fashistët, sepse sipas qasjes së falsifikuesve të historisë do të rezultonte se ata nuk morën pjesë në gjenocidin e popullit të tyre, por thjesht luftuan në anën e një prej blloqeve gjeopolitike për idealet e tyre “kombëtare”.

Drejtimi më i rëndësishëm i falsifikimit të historisë së Luftës së Dytë Botërore është mohimi i kontributit vendimtar të Bashkimit Sovjetik në fitoren dhe imponimi i mitit të rolit “dominant” të SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe në mposhtjen e agresorëve fashistë.

Përpiqen gjithashtu të shtrembërojnë thelbin e misionit çlirimtar të BRSS në Luftën e Dytë Botërore. Ata e paraqesin çlirimin e Europës nga Bashkimi Sovjetik si një përpjekje për ta pushtuar atë dhe për të zgjeruar sferën e tij të ndikimit. Disa autorë-falsifikatorë, pa u munduar të studiojnë faktet, e akuzojnë Ushtrinë e Kuqe për “mizori”, për “dhunë dhe grabitje” në ter-

ritoret që ajo çliroi, “sidomos në Gjermani”. Por askush nuk përmend urdhrat e komandës sovjetike, që ndaluan veprimet e dhunshme kundër popullsisë vendase, apo heroizmat e ushtarëve sovjetikë për shpëtimin e popullatës civile. Dhe, natyrisht, asgjë nuk thuhet për ndihmën materiale dhe teknike të komandës sovjetike për popullsinë e Berlinit dhe qyteteve të tjera në Gjermani.

BAZUAR NË REZULTATET DHE PASOJAT E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE, MUND TË PËRMENDIM MËSIMET KRYESORE TË SAJ:



Rrënojat e Stalingradit, 1943

- Lufta e Tretë Botërore nuk mund të lejohet të ndodhë, në të nuk do të kishte fitues, do të mbeteshin vetëm rrënojat e qytetërimit;
- Kriza e besimit ndërmjet shteteve nuk duhet të lejohet të thellohet, pasi mungesa e një sistemi sigurie kolektive krijon një situatë që do ta tërheqë gradualisht njerëzimin në luftë ose në konflikte lokale;
- Bazuar në përvojën e hidhur të luftës, nuk duhet të ndiqet politika e “zbutjes” ndaj agresorëve, marrëveshjeve joparimore dhe protokolleve sekrete, nuk duhet lejuar fshirja e “kufijve dallues” mes demokracisë, fashizmit dhe neo-nazizmit, pasi kjo krijon kushte për shpërthimin e konflikteve të armatosura;
- Nuk mund të garantohet siguria e një vendi në kurriz të vendeve të tjera; është e nevojshme të ruhet vazhdimisht raporti ndërmjet politikës dhe moralit. Kanë kaluar 80 vjet nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, por ne nuk mund ta harrojmë këtë dhe të lejojmë përsëritjen e saj në të ardhmen. Komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë vigjilent dhe të mos harrojë thënien proverbiale të Bertolt Brehtit në dramën e tij “Arturo Ui”: “Mitra që e lindi fashizmin është ende fertile sot”. Njerëzimi nuk mund të lejojë që tragjedia e “vetëvrasjes kolektive” të përsëritet. Çdo problem global i njerëzimit, para së gjithash, ruajtja e paqes, mund dhe duhet të zgjidhet vetëm me përpjekje të përbashkëta, edhe në prani të kontradiktave serioze që ekzistojnë në botën moderne.

Sot, në 80-vjetorin e fitores ndaj nazifashizmit jemi në prag të një etape të re të perceptimit të historisë. Gjithnjë e më shumë njerëz kuptojnë se shtrembërimet dhe përpjekjet për falsifikimin e saj janë të rrezikshme për shoqërinë, sepse shkatërrojnë ndërgjegjen historike dhe kujtesën e popujve, deformojnë moralin shoqëror dhe individual dhe minojnë themelet e sigurisë ndërkombëtare.

HISTORIA SI UDHËZIM PËR TË ARDHMEN!



Nga Marjana DODA

Kryeredaktore-Argumentum.al

“

Në këndvështrimin historik, 80-vjetori i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore është një moment thelbësor. Është një mundësi për të reflektuar mbi shkallën e paimagjinueshme të vuajtjeve dhe sakrificave që riformuan shekullin e 20-të, ku dhjetëra miliona jetë njerëzore humbën dhe pasojat e luftës ende formojnë sot politikën, kufijtë dhe aleancat globale.

“Ata që nuk mund ta kujtojnë të kaluarën janë të dënur ta përsërisin atë.”

Kjo thënie mbetet një kujtesë e fortë për rëndësinë e historisë, pasi sa herë i kthehemi asaj, kuptojmë më mirë të tashmen dhe mësojmë si të mos përsërisim gabimet e së djeshmes.

Përvjetori i 80-të i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore nuk është thjesht një datë për t'u përkujtuar, por një mësim i madh për të gjithë botën. Një kujtesë që paqja nuk është e garantuar dhe se tensionet, padrejtësitë e konfliktet ende sot janë të pranishme, edhe pse ndoshta nuk duken me të njëjtin intensitet si dikur.

Ndaj, më shumë se kurrë, na duhet të rikujtojmë atë që ndodhi, jo për të jetuar në të kaluarën, por për të ndërtuar një të ardhme më të sigurtë.

Për këtë është e rëndësishme të nënvizojmë disa momente kyçe që tregojnë mënyrën se si e lexojmë historinë, në një kontekst

më të gjerë global.

Në këndvështrimin historik, 80-vjetori i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore është një moment thelbësor. Është një mundësi për të reflektuar mbi shkallën e paimagjinueshme të vuajtjeve dhe sakrificave që riformuan shekullin e 20-të, ku dhjetëra miliona jetë njerëzore humbën dhe pasojat e luftës ende formojnë sot politikën, kufijtë dhe aleancat globale. Për vende si Rusia (atëherë Bashkimi Sovjetik), lufta nuk ishte vetëm globale - ajo ishte ekzistenciale. Vetëm Fronti Lindor pa disa nga luftimet më brutale në historinë njerëzore. Për shumë rusë, fitorja në atë që ata e quajnë Lufta e Madhe Patriotike është thellësisht personale dhe e shenjtë.

Nga pikëpamja globale, ky përvjetor është pak më i komplikuar se të kaluarat. Vendet perëndimore po lundrojnë se si të përkujtojnë fitoren e përbashkët mbi Gjermaninë naziste,

ndërsa menaxhojnë gjithashtu marrëdhëniet e tensionuara me Rusinë për shkak të konfliktit të armatosur në Ukrainë. Pra, ka pikëpyetje: si i nderoni sakrificat e ushtarëve sovjetikë pa miratuar politikën e qeverisë aktuale ruse?

Dhe nga një këndvështrim njerëzor, ky është ndoshta përvjetori i fundit ku do të ketë ende veteranë dhe të mbijetuar të gjallë që mund të ndajnë historitë e tyre në veten e parë.

Megjithatë përkujtimi i Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht në prag të 80-vjetorit, nuk ka të bëjë vetëm me nderimin e ushtarëve dhe civilëve që vuajtën apo sakrifikuan, por edhe me detyrimin për të ruajtur dhe përcjellë mësimet që kjo luftë e tmerrshme na ka lënë. Me kalimin e kohës dhe pakësimin e atyre që e përjetuan luftën drejtpërdrejtë, bëhet gjithnjë e më urgjente rëndësia e kujtesës kolektive dhe trashëgimisë historike, për të mos harruar dhe

për të parandaluar që e njëjta histori të përsëritet.

Në këtë kontekst, kujtesa bëhet gjithashtu një armë e fuqishme kundër përpjekjeve për të ndryshuar ose manipuluar historinë, të cilat mund të shpërndajnë të pavërteta dhe të rrezikojnë stabilitetin dhe harmoninë ndërkombëtare. Ndaj, është e rëndësishme të mbajmë një kujtesë të bazuar në faktet reale dhe të pranojmë se, pavarësisht se çfarë ndodhi, vende të ndryshme mund ta interpretojnë të njëjtën histori në mënyra të ndryshme, por ajo që ka rëndësi është të ruhet integriteti i saj dhe të mos i jepet mundësia për të kthyer pasojat e luftës.

Ndikimi i Luftës së Dytë Botërore në rendin ndërkombëtar dhe në jetën e përditshme të sotme është i pashmangshëm. Formimi i Kombeve të Bashkuara, riformësimi i Evropës, Lufta e Ftohtë – të gjitha këto janë pasojat e drejtpërdrejtë të luftës dhe kanë krijuar strukturat ndërkombëtare që njohim sot. Krijimi i aleancave dhe fuqitë globale që u formuan pas luftës janë ende të pranishme dhe ndikojnë në mënyrën si funksionon gjeopolitika globale. Aktualisht, po përballemi me trashëgiminë e sferave të ndara të ndikimit dhe vazhdimin e një balancimi të vazhdueshëm midis NATO-s dhe Rusisë, si dhe me pasojat e rendit ndërkombëtar të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Ky rend ka sjellë konfrontime të reja dhe tensione që janë drejtpërdrejt të lidhura me historinë e Luftës së Ftohtë dhe ndryshimin e kufijve dhe strukturave të pushtetit. Lufta nuk ndryshoi vetëm hartën

gjeografike, por gjithashtu ripërcaktoi raportet e pushtetit dhe ndikimin që shtetet mund të kishin mbi njëra-tjetrën. Dhe, edhe pse ideologjitë totalitare dhe fashiste që sollën kaosin u mundën, ato ende kanë ndikim dhe jehonë në politikën globale të sotme, duke ushqyer debatet dhe konflikte që pasqyrojnë pasojat afatgjata të Luftës së Dytë Botërore.

Kjo është arsyeja pse të kujtuarit është kaq jetike tani. Nuk është vetëm një mënyrë për të nderuar të kaluarën, por edhe një mënyrë për të siguruar që bota të mos përsërisë të njëjtat gabime e të mos përjetojë të njëjtat tragjedi. Teksa shohim konfliktet në horizontin tonë gjeopolitik, ndjejmë se pasojat e injorimit të historisë mund të jenë katastrofike.

Andaj, historia nuk shërben vetëm si një regjistër i asaj që ka ndodhur, por si një udhërrëfyes për atë që duhet të shmangim. Shekulli i 20-të, me shkatërrimin e shkaktuar nga dy Luftërat Botërore, i dha njerëzimit disa prej mësimëve më të vështira dhe më të dhimbshme, për rreziqet e agresionit të pakontrolluar, dështimin e diplomacisë dhe pasojat shkatërrimtare të ekstremizmit ideologjik.

Në dritën e zhvillimeve të sotme me nacionalizmin në rritje dhe tensionet e përshkallëzuara në skenën gjeopolitike bëhet gjithnjë e më e qartë se mësimet e Luftës së Dytë Botërore mbeten thelbësore. Paqja e brishtë që pasoi atë luftë nuk ishte vetëm rezultat i një fitoreje ushtarake, por fryt i diplomacisë së kujdesshme, pajtimit midis kombeve dhe ndërtimit të strukturave ndërkombëtare si

Kombet e Bashkuara, të cilat synonin të parandalonin një tjetër katastrofë globale.

Por kjo do të duhej të kishte ndodhur që në fillim përpara se bota ta paguante kaq shtrenjtë çmimin e mosmarrëveshjeve të saj.

Mizoritë e Holokaustit, pushtimi i vendeve të tëra dhe bombardimi i civilëve janë dëshmi të qarta të kostos së tmerrshme njerëzore që vjen nga dështimi për të ndaluar agresionin në fazat e tij të hershme. Pas Luftës së Dytë Botërore, bota ndërtoi një arkitekturë të tërë ligjesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe marrëveshje për parandalimin e krimeve të luftës. Megjithatë, rreziku i rrëshqitjes drejt sjelljeve të rrezikshme dhe të pakontrolluara mbetet

”

Në dritën e zhvillimeve të sotme me nacionalizmin në rritje dhe tensionet e përshkallëzuara në skenën gjeopolitike bëhet gjithnjë e më e qartë se mësimet e Luftës së Dytë Botërore mbeten thelbësore. Paqja e brishtë që pasoi atë luftë nuk ishte vetëm rezultat i një fitoreje ushtarake, por fryt i diplomacisë së kujdesshme, pajtimit midis kombeve dhe ndërtimit të strukturave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, të cilat synonin të parandalonin një tjetër katastrofë globale.

gjithmonë i pranishëm. Kujtesa historike dhe përpjekjet për të ruajtur mësimet e saj janë më të rëndësishme se kurrë. Brezi ynë ka përgjegjësinë të mos e lejojë të kaluarën të zhduket në harresë, përndryshe, mund të na duhet të paguajmë një çmim edhe më të shtrenjtë për dështimin tonë në parandalimin e të njëjtave gabime.

Prandaj, për mua, ky përkujtim është mbi të gjitha një akt ndërgjegjësimi. Nuk ka të bëjë vetëm me pasojat e asaj lufte, por me njohjen e shkaqeve që çuan në luftë në radhë të parë. Është e nevojshme të kuptojmë se si dështimi për të adresuar shenjat e hershme të agresionit krijoi një efekt domino që shpërtheu në një konflikt shkatërrues. Mbi të gjitha, duhet të pranojmë se

Mizoritë e Holokaustit, pushtimi i vendeve të tëra dhe bombardimi i civilëve janë dëshmi të qarta të kostonë të tmerrshme njerëzore që vjen nga dështimi për të ndaluar agresionin në fazat e tij të hershme. Pas Luftës së Dytë Botërore, bota ndërtoi një arkitekturë të tërë ligjesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe marrëveshje për parandalimin e krimeve të luftës. Megjithatë, rreziku i rrëshqitjes drejt sjelljeve të rrezikshme dhe të pakontrolluara mbetet gjithmonë i pranishëm.

ka paralele moderne në politikën globale, të cilat kërkojnë vigjilencë dhe angazhim për të shmangur përsëritjen e këtyre gabimeve.

Ndihet sikur shumë liderë po u japin përparësi interesave kombëtare, ndonjëherë në kurriz të stabilitetit më të gjerë global ose paqes afatgjatë. Ne e shohim këtë me nacionalizmin dhe proteksionizmin në rritje në shumë vende, ku liderët janë më të shqetësuar për të siguruar pozicionin e vendit të tyre, edhe nëse kjo nënkupton destabilizimin e sistemeve globale.

Një çështje kryesore është se rendi global që u shfaq pas Luftës së Dytë Botërore, ai i ndërtuar rreth institucioneve si OKB-ja, marrëveshjeve ndërkombëtare të tregtisë dhe idesë së zgjidhjeve diplomatike, ndihet më i brishtë se kurrë. Bashkëpunimi dhe institucionet e krijuara pas Luftës së Dytë Botërore kishin për qëllim të parandalonin vetë konfliktet që shohim të rishfaqen sot. Por tani, të njëjtat institucione shpesh shihen me skepticizëm dhe efektiviteti i tyre vihet në pikëpyetje.

Bota duket se po lëviz drejt një "rendi" të ri, por nuk është e qartë nëse kjo botë e re është ajo që i jep përparësi paqes dhe bashkëpunimit, apo nëse është ajo që është më e fokusuar në forcimin e pushtetit përmes forcës ushtarake, dominimit ekonomik ose epërsisë ideologjike.

Kjo ndjenjë e fragmentimit është shqetësuese. Në vend që të ndërtohet mbi mësimet nga e kaluara, duket sikur bota është e ndarë në mënyrë të rrezikshme, me liderët që ndonjëherë përdorin historinë në mënyrë selektive për të jus-

tifikuar veprimet e tyre aktuale, në vend që ta lexojnë historinë ashtu siç është

Por pyetja është, çfarë mund të bëhet? Është e qartë se ne kemi nevojë për një udhëheqje të fortë që nuk mendon vetëm për vendin e tyre ose pushtetin e tyre, por për komunitetin global në tërësi.

Ne kemi nevojë për liderë që shohin përtej kufijve kombëtarë, që krijojnë dialog dhe jo ndarje, dhe që kuptojnë se paqja dhe bashkëpunimi janë rruga e vetme e qëndrueshme përpara. Për këtë, hapi i parë është shkatërrimi i mureve mes nesh.

Është e dhimbshme të shohësh se si ndarjet mes nesh janë thelluar, veçanërisht që pas fundit të Luftës së Ftohtë. Edhe pse muret fizike ranë, muret mendore mbeten të forta dhe, në disa raste, janë bërë më të larta. Dallimet që u krijuan gjatë Luftës së Ftohtë duket se janë thelluar më shumë në këto tre dekada të fundit. Por duhet ta kuptojmë se këto mure nuk janë të përjetshme. Ndërsa liderët botërorë mund të hezitojnë, është detyra e secilit prej nesh qytetarëve, aktivistëve, gazetarëve dhe organizatave, që të bëjmë ndryshimin dhe të ndërtojmë ura mes njerëzve.

Duhet të pranojmë se dallimet tona nuk janë arsye për ndarje, por mund të na forcojnë, nëse i kuptojmë dhe i respektojmë. Duhet të shohim njerëzimin që na bashkon në çdo individ dhe të heqim barrierat mendore që na mbajnë të ndarë. Vetëm kur të fillojmë të shembim këto mure mendore, mund të ecim përpara në ndërtimin e një bote më të drejtë, të bashkuar dhe të paqte.

Kontributi i Luftës Nacionalçlirimtare Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore:

Një betejë e një kombi të vogël kundër një të keqeje globale

Në rrjedhën dramatike të Luftës së Dytë Botërore, ku bota u përball me rrezikun më të madh të fashizmit dhe nazizmit, Shqipëria – një vend i vogël, i varfër tregoi një guxim të jashtëzakonshëm. Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare nuk ishte thjesht një përpjekje për çlirimin e territorit nga pushtuesit e huaj, por një manifestim i vendosmërisë së një populli për të mos u nënshtruar para padrejtësisë dhe tiranisë.

Pas pushtimit italian më 7 prill 1939, shqiptarët fillimisht u gjendën të përçarë dhe të befasu-

ar, por jo të nënshtruar. Me kalimin e kohës, lëvizjet antifashiste filluan të konsolidoheshin, duke kulmuar me themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë në nëntor 1941, e cila më vonë do të merrte drejtimin e Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo lëvizje nuk përfaqësonte vetëm një organizim ushtarak, por u shndërrua në një strukturë të gjerë popullore, me baza politike, shoqërore dhe ideologjike.

Në një vend pa ushtri të organizuar dhe me mungesë të theksuar të resurseve, qindra e mijëra burra e gra dolën në male, formuan çeta partizane, brigada dhe një sistem paralel administrativ

që filloi të marrë përgjegjësi për zonat e çliruara. Një element i rëndësishëm ishte përfshirja masive e rinisë dhe grave shqiptare në këtë lëvizje – një shenjë e qartë e karakterit përfshirës dhe popullor të saj.

Pasi Italia fashiste u dorëzua në vitin 1943, vendin e saj në Shqipëri e zuri Gjermania naziste. Megjithatë, LNÇ nuk u tërhoq – përkundrazi, ajo u fuqizua, duke shtuar aksionet dhe fitoret ndaj okupatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre vendas. Me gjithë përmasat e vogla të vendit dhe mungesën e ndihmës ushtarake të drejtpërdrejtë nga Aleatët në terren, Shqipëria arriti të çlirohet me forcat e veta më 29 nëntor 1944. Ky fakt përbën një nga rastet e rralla në Evropë ku çlirimi u arrit nga brenda.

Kontributi i Shqipërisë në Luftën





e Dytë Botërore nuk mund të matet vetëm në fitoret ushtarake apo në numrin e viktimave. Ai përfaqëson një kontribut moral dhe historik në koalicionin antifashist botëror. Shqipëria u rreshtua me anën e drejtë të historisë, duke treguar se edhe një komb i vogël, i ndarë dhe i varfër, mund të jetë një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen e lirisë njerëzore dhe vlerave demokratike.

Lufta Nacionalçlirimtare, përtej përkatësive politike që i pasuan, mbetet një kapitull madhor i historisë kombëtare dhe një dëshmi e pashlyeshme e sakrificës dhe qëndresës shqiptare. Ajo është një histori që duhet të kujtohet, jo vetëm si një fitore ndaj okupatorit, por si një mesazh i përhershëm se liria ka gjithmonë një çmim, dhe se ndonjëherë, kombet më të vegjël tregojnë kurajën më të madhe.

Rrënjët dhe Organizimi i Luftës Nacionalçlirimtare

Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 prill 1939, vendi u përfshi në një periudhë pasigurie dhe shtypjeje. Megjithatë, ndjenjat atdhetare dhe urrejtja ndaj pushtuesve u përhapën në të gjithë vendin. Më 8 nëntor 1941, u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë (më vonë PPSH), e cila mori në dorë drejtimin e lëvizjes

çlirimtare, duke organizuar popullin në çeta partizane.

LNÇ-ja u shndërrua në një lëvizje masive popullore. Deri në fund të luftës, ajo kishte mobilizuar mbi 70,000 luftëtarë, të ndarë në 24 brigada dhe 8 divizione, ku përfshiheshin edhe 6,000 gra dhe 10,000 pionierë (të rinj). Kjo përfshirje masive ishte një arritje e rrallë për një vend me pak më shumë se një milion banorë në atë kohë.

Lufta Kundër Pushtuesve: Fitore në Kushte të Pabarabarta

Pas kapitullimit të Italisë më 8 shtator 1943, Shqipëria u pushtua nga Gjermania naziste. Megjithatë, LNÇ vazhdoi luftën me intensitet më të madh. Sipas të dhënave historike, gjatë viteve të luftës:

- U asgjësuan mbi 26,000 ushtarë italianë dhe gjermanë,
- U plagosën 21,455, dhe
- U zunë rob 20,800 pushtues,
- LNÇ shkatërroi 2,100 tanke dhe automjete ushtarake dhe kapi mbi 4,000 topa dhe mortaja të kalibrave të ndryshëm.

Për më tepër, shqiptarët arritën të krijonin zona të lira, ku u ngritën Këshillat Nacionalçlirimtare, si forma të para të administrimit të pavarur, duke vendosur baza të një shteti të ardhshëm të çliruar.

Sakrificat e Popullit dhe Pesha e Luftës

Kjo luftë pati një kosto të madhe për shqiptarët. Sipas burimeve zyrtare dhe dokumenteve historike:

- U vranë 28,000 persona,
- U plagosën 12,600,
- U burgosën 10,000 shqiptarë
- Mbi 62,000 shtëpi u shkatërruan dhe ekonomia kombëtare pësoi humbje kolosale, duke përfshirë edhe 8 miliardë franga ari të grabitura nga pushtuesit.

Vlerësimi Ndërkombëtar dhe Roli në Koalicionin Antifashist

Kontributi i Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore nuk kaloi pa u vënë re nga forcat aleate. Në një fjalim në Dhomën e Komunave në Londër, më 5 nëntor 1943, Winston Churchill deklaroi:

“Luftëtarët shqiptarë që luftojnë në male për lirinë dhe pavarësinë e vendit të tyre janë një shembull i guximit dhe vendosmërisë.”


Pikërisht për shkak të këtij qëndrimi të vendosur, Shqipëria u rendit në radhën e shteteve fituese të luftës, duke fituar një vend në skenën ndërkombëtare si një vend që nuk u nënshtrua, por luftoi me dinjitet dhe përkushtim.

Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare ishte një betejë për identitetin kombëtar, për dinjitetin dhe për të ardhmen e një populli që nuk pranoi të nënshtrohej. Shqipëria, megjithëse e vogël dhe e varfër, tregoi se forca e vërtetë e një kombi matet me qëndresën, me guximin dhe me sakrificën për liri.

Ky kapitull i lavdishëm i historisë duhet të kujtohet me respekt, sepse përfaqëson atë që kombet e mëdha nuk mund të blejnë: krenarinë e fituar me gjak dhe sakrificë.

Lavdi të përjetëshme dëshmorëve që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë!

Ambasada e Rusisë në Tiranë organizon aktivitete me rastin e 80 vjetorit të Fitores së Madhe



Dita e Fitores, e shënuar nga qytetarët rusë më 9 maj, festohet gjerësisht në shumë vende të botës, duke kujtuar bëmën e madhe të të gjithë popujve që kontribuan në mposhtjen e nazizmit dhe fashizmit. Ambasada e Rusisë në Shqipëri gjithashtu organizoi aktivitete kushtuar 80-vjetorit të Fitores.

Një ngjarje e ndritur në jetën kulturore të kryeqytetit shqiptar u bë koncerti i grupeve të famshme artistike ruse “Kori i Turetsky” dhe “Soprano” nën drejtimin e artistit të popullit të Rusisë, M.B. Turetsky, i cili u zhvillua në Qen-



drën Kulturore të Kishës Ortodokse të Shqipërisë në Tiranë. Muzikantët performuan një program festiv “Këngët e Fitores”. Të ftuarit e koncertit – përfaqësues të trupit diplomatik, figura kulturore, gazetarë dhe sipërmarrës, qytetarë rusë që jetojnë në

Shqipëri, shijuan interpretimin virtuos të këngëve të famshme “Netët e Moskës”, “Smuglyanka”, “Shamia blu”, “Kalinka”, si dhe kompozimeve të tjera klasike dhe të njohura si në rusisht, ashtu edhe në gjuhë të huaja. Koncerti i zhvilluar konfirmoi edhe një herë të vërtetën e thjeshtë: pavarësisht gjendjes aktuale politike, kultura dhe arti gjithmonë jetojnë, zhvillohen, shtrojnë rrugën e tyre drejt njerëzve, bashkojnë vende dhe kombe.

Në kinema “Cineplexx”, stafi i misionit diplomatik organizoi një shfaqje të filmit artistik rus “T-34”, i cili tregon se si kadeti i

sapodiplomuar Nikolai Ivushkin, duke u gjendur në robërinë gjermane, planifikon një arratisje të guximshme. Ai mbledh ekui-pazhin e tij dhe me tankun legjendar sovjetik T-34 sfidon aset e tankeve gjermane. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të inteligjencies shqiptare, të diplomuar shqiptarë në universitetet ruse, ndjekësit e rrjeteve sociale të Ambasadës, si dhe qytetarë rusë.

Në kuadër të fushatës ndërkombëtare “Kopshti i Kujtimit” u mbollën pemë të reja. Qëllimi kryesor i iniciativës, e cila u nis nga lëvizja shoqerore mbarëruse “Vullnetarët e Fitores” në 2020, është mbjellja e 27 milionë pemëve në kujtim të të gjithë atyre që dhanë jetë në luftën kundër nazizmit dhe fashizmit gjatë Luftës së Madhe Patriotike 1941-1945. Gjatë pesë viteve të ekzistencës së nismës, miliona vullnetarë nga më shumë se 80 vende i janë bashkuar asaj dhe së bashku kanë mbjellë mbi 130 milionë pemë.

Më 25 prill, në Ambasadën e Rusisë në Shqipëri u zhvillua projekti ndërkombëtar “Diktimi i Fitores”, që synon të tërheqë vëmendjen e publikut rus dhe të huaj për rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike, të studimit të historisë së Luftës së Dytë Botërore, të nxjerrjes së mësimave të nev-



ojshme, si dhe të theksojë rolin vendimtar të BRSS-së dhe Ushtrisë së Kuqe në mposhtjen e nazizmit dhe fashizmit.

Sipas traditës, në prag të Ditës së Fitores, në Ambasadën e Rusisë në Shqipëri u zhvillua një pritje solemne me rastin e 80-vjetorit të Fitores. Në selinë e mision-

it diplomatik me pjesëmarrjen e bashkatdhetarëve u mbajtën nisma “Shiriti i Shën Gjergjit”, si dhe ekspozitat “Fytyra të Fitores” dhe “Regjimenti ynë i Pavdekshëm”, që synojnë ruajtjen në çdo familje të kujtimit të brezit të heronjve fitimtarë.

Vetë iniciativa “Regjimenti i Pavdekshëm” lindi në Rusi në 2012 dhe me kalimin e kohës u bë gjerësisht e përhapur. Sot, kjo nismë mbulon të gjithë botën - nga Kina në Arabinë Saudite, nga India në Brazil, nga Gjermania në Afrikën e Jugut. Çdo vit, në aktivitet së bashku me qytetarët rusë - pasardhës të pjesëmarrësve në Luftën e Madhe Patriotike 1941-1945, po marrin pjesë aktive edhe të afërmit e veteranëve të forcave aleate dhe heronjve të Rezistencës.



Ngjarjet dhe Zhvillimet kyçe gjatë Luftës së Dytë Botërore

Lufta e Dytë Botërore, që zgjati nga 1939 deri në 1945, ishte një konflikt global që përfshiu shumicën e kombeve të botës dhe që ndihmoi në formësimin e historisë moderne. Ajo përfshinte dy blloqe kryesore: fuqitë e Aleatëve (si Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara) dhe fuqitë e Boshtit (Gjermania, Italia, Japonia). Megjithatë, ndikimi i kësaj lufte nuk u kufizua vetëm në Europë, por u shtri dhe në Azinë, Afrikën dhe Paqësorin, duke pasur pasojë të mëdha për zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore të këtyre rajoneve.

Europa dhe Azia: Dy Frontet e Luftës së Dytë Botërore

Në Europë, Lufta e Dytë Botërore nisi me invadimin e Polonisë nga Gjermania më 1 shtator 1939, dhe shumë shpejt, lufta përfshiu një numër të madh vendesh të tjera, si Franca, Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik dhe Italinë. Ky konflikt u karakterizua nga përpjekjet e fuqive të Boshtit për të zgjeruar territoret e tyre dhe për të krijuar një rend të ri botëror, me Nazizmin dhe Fashizmin në qendër të ideologjive që kërkonin dominim global.

Në të njëjtën kohë, në Azi, Japonia, një nga fuqitë kryesore të Boshtit, kërkoi të zgjeronte ndikimin e saj në rajon. Ajo pushtoi Kina që nga vitet 1930 dhe vazhdoi me sulme të tjera në lindje të Azisë. Më 7 dhjetor 1941, sulmi i Japonisë ndaj Pearl Harbor çoi në përfshirjen e Shteteve të Bash-



Konferenca e Krimesë/ Jaltë, 4-11 shkurt 1945

kuara në luftë dhe zgjeroi konfliktin në Paqësor.

Ndikimi i Luftës në Azinë Lindore

Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore në Europë, konflikti i Boshtit dhe aleatëve u zgjerua në Azi, ku Japonia u përpoq të krijonte një "Sferë të Prosperitetit të Azisë Lindore", një imperium të krijuar nën sundimin japonez. Lufta në Azi, si dhe ndikimi i saj global, ndikuan në ndryshimin e strukturave politike dhe ekonomike të rajonit, duke pasur pasojë të mëdha për vendet aziatike.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme ishte Lufta e Paqësorit, ku Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë luftuan kundër Japonisë. Pas sulmit të Pearl Harbor, Japonia pushtoi shumë ishuj në Paqësor dhe kishte si objektiv dominimin e lindjes së Azisë. Lufta në Azi ka pasur ndikime të mëdha për rajonin, duke sjellë pas Luftës së Dytë Botërore një ndryshim të thellë në

balancën e fuqisë dhe një periudhë të re dekolonizimi, me shumë shtete aziatike që shpallën pavarësinë e tyre.

Disa nga datat kyçe dhe ngjarjet që ndodhën gjatë kësaj periudhe:

1939

- 1 shtator 1939: Gjermania sulmon Poloninë, duke e shkaktuar fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Kjo çoi në shpalljen e luftës nga Britania e Madhe dhe Franca ndaj Gjermanisë.
- 3 shtator 1939: Britania e Madhe dhe Francashpallin luftë ndaj Gjermanisë pas sulmit ndaj Polonisë.

1940

- 9 prill 1940: Gjermania fillon pushtimin e Danimarkës dhe Norvegjisë në kuadër të operacionit "Weserübung".
- 10 maj 1940: Gjermania sulmon Francën, Belgjikën, Holandën dhe Luksemburgun (faza fillestare e

“luftës së shpejtë”). Pushtimi i Francës fillon.

- 22 qershor 1940: Franca dorëzohet ndaj Gjermanisë dhe nënshkruhet armëpushimi.
- 14 gusht 1940: Lufta ajrore mes Gjermanisë dhe Britanisë (“Beteja e Britanisë”) fillon dhe përfundon në vitin 1941 me fitore për Britaninë e Madhe.

1941

- 22 qershor 1941: Gjermania nis sulmin ndaj Bashkimit Sovjetik me operacionin “Barbarosa”, duke e thyer pakti i jo-agresionit me Sovjetikët.
- 7 dhjetor 1941: Japonia sulmon Pearl Harbor, një bazë ushtarake amerikane në Hawaii. Kjo çon në shpalljen e luftës nga Shtetet e Bashkuara ndaj Japonisë dhe Gjermanisë.

1942

- 4-7 qershor 1942: Beteja e Midway, një përplasje detare e rëndësishme mes SHBA dhe Japonisë, ku SHBA arrin një fitore të madhe dhe ndalon avancimin e Japonisë në Paqësor.



Bllokada e Leningradit,
8 shtator 1941-27 janar 1944



Beteja e Stalingradit, 17 korrik 1942 - 2 shkurt 1943

- 19 gusht 1942: Beteja e Dieppe, një dështim i një operacioni të përbashkët britanik-kanadez për të pushtuar qytetin e Dieppe në Francë, me shumë viktima.
- 1943
- 2 shkurt 1943: Beteja e Stalingradit përfundon me dorëzimin e ushtrisë gjermane, që shënon kthesën në Luftën e Madhe Patriotike në favor të Bashkimit Sovjetik.
- 10 korrik 1943: Forcat aleate zbarkojnë në Sicili, duke filluar fushatën e pushtimit të Italisë.
- 3 shtator 1943: Italia nënshkruan armëpushimin me aleatët, por lufta vazhdon mes forcave të aleatëve dhe ushtarëve gjer-

manë që mbështesin regjimin fashist të Mussolinit.

1944


- 6 qershor 1944: Dita D (D-Day) – Aleatët zbarkojnë në Normandi (Franca), duke filluar pushtimin e Evropës Perëndimore.
- 20 korrik 1944: Pervendosja e një komploti për të vrarë Adolf Hitlerin nga oficerë të lartë të ushtrisë gjermane, i njohur si “Komploti i 20 Korrikut”, që dështoi.

1945

- 30 prill 1945: Adolf Hitler, udhëheqësi i Reichut të Tretë, kryen vetëvrasje në bunkerin e tij në Berlin, pasi situata është e dëshpëruar për Gjermaninë.
 - 8 maj (9 maj sipas orës së Moskës) 1945: në Karlhorst pranë Berlinit u nënshkrua Akti i Kapitullimit të Plotë dhe pa Kushte të Gjermanisë. Lufta në Evropë përfundon (V-E Day, Dita e Fitores në Evropë).
 - 6 dhe 9 gusht 1945: Shtetet e Bashkuara hedhën bomba atomike mbi Hiroshima dhe Nagasaki, Japonia.
 - 2 shtator 1945: Japonia dorëzohet, dhe Lufta e Dytë Botërore përfundon (V-J Day, Dita e Fitores mbi Japoninë).
- Lufta e Dytë Botërore. Ajo përfshiu më shumë se 100 milionë ushtarë dhe pati pasoja të mëdha për rregullin botëror të pasluftës.




Takimi i aleatëve - Ushtrisë së Kuqe me trupat e Ushtrisë së Parë të SHBA-së në lumin e Elbës, 25 prill 1945



Regjimenti i Pavdekshëm

Regjimenti i Pavdekshëm



Të nderuar lexues dhe ndjekës të **Argumentum.al**,

Që nga viti 2022, **Argumentum.al** vjen gjithashtu edhe në versionin e një Reviste të përmuajshme politike-diplomatike, e cila është e disponueshme për t'u shfletuar online.

Ky botim mujor ofron një përmbledhje të qartë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme, si në nivel vendi, ashtu edhe në rajon e botë. Gjithashtu, revista ofron analiza dhe opinione të thelluara mbi ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë muajit.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë. **Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj.

Në të njëjtën kohë **Argumentum.al** është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj. Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten **Argumentum.al** në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA

Kryeredaktore



© 2024 Argumentum. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Revista “Argumentum” nuk mund të riprodhohet në asnjë formë pa lejen me shkrim të botuesit.



Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga "Abdyl Frasheri", Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

**Email: redaksia.argumentum@gmail.com,
info@argumentum.al**

NUIS/NIPT: L91415033Q

Twiter : [Argumentum_al](#)

Facebook: [argumentum.al](#)

Instagram: [argumentumnews](#)

© Argumentum. All rights reserved